



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:271528

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06232344

CA.nr.9712/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Fatmir Baloku dhe Lumni Sallauka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit - propozuesit të masës së sigurimit H.K., nga Prishtina, rr. "...", nr..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.P., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit R.K. nga fshati M., Komuna e Prishtinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë M.M. dhe L.S., të dy avokat në Prishtinë, me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës të paditurit - kundërshtarit të sigurimit, e ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.7601/23, të datës 25.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit – kundërshtarit të sigurimit H.K., nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.7601/23, i datës 25.07.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.7601/23, të datës 25.07.2024, ka vendosur si në vijim: "I. APROVOHET si i bazuar propozimi i paditësit - propozuesit të sigurimit H.K. nga Prishtina, për caktimin e masës së sigurimit, ashtu që: I NDALOHET kundërshtarit të sigurimit R.K. nga fshati M., Komuna e Prishtinës, tjetërsimi, shitja, apo ngarkimi me barrë i njësisë kadastrale e cila evidentohet si ngastra: P-..., Zona Kadastrale M., vendi i quajtur "G.", lloji i njësisë parcelë, lloji i pronës private, në sipërfaqe prej 2618 m2, zona rurale, lloji i shfrytëzimit të parcelës - bujqësore, shfrytëzimi aktual kullosë, kualiteti kullosë e klasës 4, deri në një vendim tjetër të Gjykatës; II. Një kopje e këtij aktvendimi do t'i dorëzohet Komunës së Prishtinës - Drejtorisë për Kadastër dhe Pronë, si organ publik kompetent, si dhe Odës së Noterëve të Republikës së Kosovës, në mënyrë që ndalimi nga pika I e dispozitivit të këtij aktvendimi të evidentohet në regjistrat publikë".

Kundër këtij aktvendimi i padituri - kundërshtari i masës së sigurimit, përmes të autorizuarve të tij, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurit- kundërshtarit të masës së sigurimit, ndërsa aktvendimin e atakuar C.nr.7601/23, i datës 25.07.2024, ta ndryshojë ashtu që të refuzohet si i pabazuar propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurisë apo aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në ri procedurë.

Paditësi – propozuesit i masës së sigurisë brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në ankesën e kundërshtarit të sigurimit, me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzoj si të pabazuar ankesën e kundërshtarit të sigurimit, ndërsa aktvendimin e atakuar C.nr.7601/23, të datës 25.07.2024, ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të kundërshtarit të sigurimit, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit – kundërshtarit të sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi- propozuesi i masës së sigurimit me datë 07.12.2023, në gjykatës e shkallës së parë, ka ushtruar padi kundër të paditurve R.K. nga fshati M., Komuna e Prishtinës dhe A.K. nga Prishtina, për vërtetimin e pronësisë dhe dorëzimin e pronës, me propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Në seancën dëgjimore të datës 01.07.2024 paditësit – propozuesi ka precizuar kërkesëpandinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, duke kërkuar që të caktohet masa e sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit R.K., me arsyet sikurse në padi-propozim, ndërsa ndaj kundërshtarit të sigurimit A.K. ka tërhequr propozimin për caktimin e masës së sigurimit ndaj njësisë kadastrale ..., ..., ... dhe I padituri – kundërshtari i sigurimit R.K. përmes përgjigjes ndaj propozimit dhe në seancën dëgjimore e ka kontestuar propozimin e ushtruar dhe ka kërkuar që propozimi për caktimin e masës së sigurisë të refuzohet si i pabazuar duke konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht ka mbajtur seancë dëgjimore me datë 19.04.2024 në të cilën ka vendosur për nxjerrjen e ekspertizës gjeodezike dhe daljen në vendshikim. Me datën 17.05.2024 është mbajtur seanca në vendshikim, ndërsa në seancën e datës 17.07.2024 janë dëgjuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, nga të cilat pretendime dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse - propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, është i bazuar, andaj ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar C.nr.7601/23, i datës 25.07.2024.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, pas administrimit të provave, deklarimit të palëve dhe leximit të ekspertizës së gjeodezisë, ka theksuar se kushti ligjor i nga neni 297 par.1 pika a) i LPK është përmbushur pasi që ka konstatuar se besueshmëria e ekzistimit të kërkesës apo të drejtës subjektive të propozuesit të sigurimit buron nga fakti se si paraardhësi

i propozuesit (H.K.), ashtu edhe paraardhësi i kundërshtarit të sigurimit (A.K.), kanë qenë trashëgimtarë në pjesë të barabarta të pasurisë së paraardhësit të tyre A.K., përfshirë edhe të ngastrës kadastrale lëndore. Ndërsa, lidhur me kushtin e ekzistimit të rrezikut i cili përcaktohet me pikën b) të po të njëjtit nen, gjykata ka theksuar se nga shkresat e lëndës rezulton se kundërshtari i sigurimit në të kaluarën ka bërë tjetërsimin e ngastrave të cilat janë evidentuar në emrin e tij, andaj ekziston rreziku që në të ardhmen të bëjë tjetërsimin e ngastrës kadastrale lëndore, duke pamundësuar apo vështirësuar dukshëm realizimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Prandaj, gjykata ka vlerësuar se propozimi për caktimin e masës së sigurimit është i bazuar, andaj për të njëjtin ka vendosur konform nenit 300 par.1 pika a) dhe 307 par.1 të LPK-së. Tutje, gjykata konform nenit 297 part.2 të LPK-së ka nxjerrë aktvendim me të cilin ka caktuar garancionin për sigurimin e dëmit eventual, mirëpo pas kërkesës së propozuesit për lirim nga pagesa e garancionit, konform par.3 të po të njëjtit nen, gjykata ka abroguar atë aktvendim pasi që propozuesi ka arritur të provoj faktin se nuk gëzon mundësi financiare për pagesën e shumës së garancionit.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Po ashtu aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas dispozitës së nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK-së, përcaktohet në mënyrë të qartë se masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, për shkak se paditësi – propozuesi i masës së sigurimit e ka bërë në masë të mjaftueshme të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive dhe ekzistimin e rrezikut se pala kundërshtarë do t'ia pamundësonte ose vështirësonte realizimin e kërkesës së tij nëse nuk caktohet masa e sigurimit, ndërsa propozuesi është liruar nga pagesa e garancionit, konform par.3 të nenit 297 të LPK-së, pasi që i njëjti ka arritur të provoj faktin se nuk gëzon mundësi financiare për pagesën e shumës së garancionit të caktuar nga gjykata.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se propozimi i paditësit - propozuesit për caktimin e masës së sigurisë është i bazuar, e pranon në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë si vlerësim të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se është plotësuar kushti ligjor i ekzistimit të drejtës subjektive për caktimin e masës së sigurimit, siç përcaktohet me nenin 297 par.1, pika a) të LPK-së, sipas të cilit: *“Masa e sigurimit mund të caktohet në rast se propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës së tij subjektive”*. Gjithashtu duke qenë se

me pikën b) të po të njëjtit paragraf parashihet se *“Përveç kushtit ligjor nën pikën a) duhet të vërtetohet se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të çështjes apo në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, mund të përfundojmë se në rastin konkret është përmbushur edhe kushti i ekzistimit të rrezikut. Nga interpretimi i këtyre dispozitave rezulton se kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 297 par.1, pika a) dhe b) të LPK-së, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, që në rastin konkret janë plotësuar.

Më konkretisht, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme përse në rastin konkret duhet të caktohet masa e sigurisë e propozuar nga ana e propozuesit që ka të bëjë me ndalimin e kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsoj, shes apo ngarkojë me barrë njësinë kadastrale e cila evidentohet si ngastra: P-..., Zona Kadastrale M., vendi i quajtur "G.", lloji i njësisë parcelë, lloji i pronës private, në sipërfaqe prej 2618 m², zona rurale, lloji i shfrytëzimit të parcelës - bujqësore, shfrytëzimi aktual kullosë, kualiteti kullosë e klasës 4, deri në një vendim tjetër të gjykatës. Kjo sepse në bazë të aktvendimit T.nr.94/82, i datës 25.05.1982, aktvendimit LRP.nr.22432/17, Ref. Tr.4656/17, i datës 06.12.2017, certifikatave të vdekjes së paraardhësve të palëve ndërgjyqëse, certifikatave të lindjes të palëve ndërgjyqëse, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përfshirë këtu ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, del se paditësi – propozuesi i masës së sigurisë e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tij subjektive, pasi që e njëjta buron nga fakti se si paraardhësi i propozuesit (H.K.), ashtu edhe paraardhësi i kundërshtarit të sigurimit (A.K.), kanë qenë trashëgimtarë në pjesë të barabarta të pasurisë së paraardhësit të tyre Ajet Krasniqi, në të cilën pasuri bën pjesë edhe ngastra kadastrale për të cilën është kërkuar caktimi i masës së sigurisë.

Për më tepër, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë sa i përket plotësimit të kushtit ligjor të ekzistimit të rrezikut, me të drejtë ka konstatuar se duke iu referuar të gjeturave nga ekspertiza e gjeodezisë, përkatësisht historiatit zyrtar të ngastrave kontestuese, rezulton se kundërshtari i sigurimit në të kaluarën ka bërë tjetërsimin e ngastrave të cilat janë evidentuar në emrin e tij, andaj edhe sipas bindjes së kësaj gjykate, në rastin konkret ekziston rreziku që pa caktimin e kësaj mase të sigurimit, paditësit - propozuesit do t'i vështirësohej realizimi i të drejtës subjektive të tij, e aq më tepër kur në rastin konkret shqyrtimi i trashëgimisë duke përfshirë edhe ngastrën lëndore është bërë pa u njoftuar propozuesi i sigurimit si trashëgimtar nga paraardhësi H.K..

Sa i përket pretendimit të paditurit – kundërshtarit të masës së sigurisë se gjykata e shkallës së parë ka tejkalluar kërkesëpadinë dhe propozimin duk e vendosur masën e sigurisë në tërë palujtshmërinë, ndonëse nga paditësi – propozuesi është kërkuar vetëm ½ e palujtshmërisë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim i pabazuar. Kjo për shkak se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka caktuar masën e sigurisë në tërë palujtshmërinë që është objekt shqyrtimi, meqë në rastin konkret duke iu referuar ekspertizës së gjeodezisë rezulton se kjo ngastër kontestuese nuk është e parcelizuar dhe sipas gjendjes faktike nuk dihet së cila pjesë do t'i takonte propozuesit në rast se kërkesëpadia rezulton të jetë e bazuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të paditurve-kundërshtarëve të masës së sigurimit, për faktin se referuar shkresave të lëndës, i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur që të aprovojë propozimin e palës paditëse - propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurisë mbi ngastrën lëndore. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sikurse në dispozitivi të aktvendimit të atakuar, ka zbatuar në tërësi dispozitat përkatëse ligjore dhe atë nenin 297 par.1, pika a) dhe b) të LPK-së, si dhe par. 2 të po këtij neni. Kjo për faktin se paditësi-propozuesi i sigurimit, përmes provave të parashtruara dhe të administruara në gjykatën e shkallës së parë, e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive të tij në raport me ngastrën kontestuese dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e kësaj mase pala kundërshtarë do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pronës objekt i kontestit. Kjo do të thotë se nga gjykata do të merret si e mjaftueshme nëse propozuesi vetëm e bën të besueshme (jo të bazuar) të drejtën e tij subjektive, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me sigurimin e kërkesëpadisë së paditësit-propozuesit, e jo vendosjen në meritum (zgjidhjen përfundimtare të çështjes kontestuese), ndërsa kjo e fundit vjen si rezultat i zhvillimit të procedurës kontestimore, mbajtjes së shqyrtimit përgatitor dhe kryesor, administrimit të të gjitha provave materiale të propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të tyre nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë, për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.9712/2024, datë 30.09.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci